



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 62 prot.

Kamëz, më 11.04.2023

V E N D I M

Nr. 50.Datë 11/04 2023

M B I

“NDRYSHIM EMËRTIMI RRUGËSH NË TERRITORIN E BASHKISË
KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 11.04.2023, pasi mori në shqyrtim kërkesën për ndryshimin e emërimit të rrugës nga “Helsinki” në “Koleci” datë 11.04.2023, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ll” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; nenit 3, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar; Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I :

- Emërtimin “Koleci” rrugës sipas fragmentit të hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.
- Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi, shfuqizohet.
- Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

